

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr./Br. 1131/20  
Datë/Datum. 23.12.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: KOMUNA E GJILANIT

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 651-20-7502-2-3-6

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: Dezinfekant, Mirembajtja e tunelit si dhe dezinfektimi i Objekteve shendetimore

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

MEB L.L.C

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

EDIT DURHAM 213

(Adresa)

PRIZREN

(Vendi)

045 566 065

(Numri Telefonit)

20 000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

SEFCET DAMKA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

meb.llc1@gmail.com

(Adresa elektronike)

22.12.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

-Njoftimi për kontratë I publikuar me datë 11.11.2020

-Afati i fundit për dorëzim ka qenë 17.11.2020 të njëjtën ditë është bërë hapja e ofertave,

-Procesverbal me datë 17.12.2020

-Kriter për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

-Leter standard e kërkesës për informata mbi tenderin, me datë 30.11.2020

-Njoftimi mbi vendimin e autoriteti kontraktues për dhënie të kontratës me dt.11.12.2020,

-Leter standarde për tenderuesit eliminuar me dt.11.12.2019

-Kërkesa për ri-shqyrtim 22.05.2020,

-Vendimi për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim me dt.15.12.2020

AK me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe atë të neneve si më poshtë:

Nenin 1,

Neni 6,

Neni 7,

Neni 52,

Neni 59,

Nenin 72

Nenit 108A të LPP.

## **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshtetja rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në pajtim me dispozitat e nenit 109 parashtojmë këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të prokurimit me rastin e refuzimit të kërkesës sonë për ri-shqyrtim si dhe për arsyet e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit përmes njoftimit me letër standarde për tenderuesit e eliminuar si dhe rekomandimin e OE për kontratë.

AK-Komuna e Gjilanit me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e në veqanti me rastin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderve por edhe me rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës sonë na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit dhe duke rekomanduar për kontratë një OE i cili ka qmimim

dukshëm më të lartë se ne për rreth 879,40 euro.

AK me rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës tonë nuk jep përgjigje për pretendimet tona ankimore, nga vendimi i tyre shifet se e njehta fare nuk ka shqyrtuar kërkesën tonë por me një fjali të vetme ka konstatuar se nuk qëndrojnë pretendimet e juaja pa dhënë arsyetim fare.

Lidhur me shqetsimet tona si pal me interes juridik dhe material e njoftojm panelin shqyrtues me pretendimet tona si më poshtë :

-Kuvendi Komunal i Gjilanit si autoritet kontraktues ka përdoruar nenin 72 ku neve na ka ftuar për sqarim apo konsultim lidhur me ofertën tonë.

**E-maili i derguar me daten 30.11.2020-Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tenderet.**

#### **Kerkesa e Autoritetit Kontraktues**

Duke u bazuar ne Rregullat per tenderët Jo-Normalisht te ulet nenin 3,ku ju i keni plotësuar te gjitha kushtet per tu trajtuar oferta e juaj si tender jo normalisht te ulet pasi :

Çmimi i ofruar nga Ju është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; Janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Komisioni i vlerësimit te ofertave ka konsideruar që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, për pozicionet si në vijim.



Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plafisimi Supplement/Amendment Dopuna/Izmjena
1.	EVERY DAY VM, Vellezerit Gervalla, 70000, Ferizaj	007	Dezifekant ,Mirembajtja e tunelit si dhe dezifektimi i Objekteve shendetsores	PO	7750,15	9451,40	JO
2.	"NEB" L.L.C., Edit Durham 213, 20000, Prizren	651-20-7502-2-3-6	Dezifekant ,Mirembajtja e tunelit si dhe dezifektimi i Objekteve shendetsores	PO	7264,41	8572,00	JO
3.	S.V. Veterina, 65 rr.Qemeris, 1005297199, VUSHTRRI	S.V.- K.K. Gjilan	Dezifekant ,Mirembajtja e tunelit si dhe dezifektimi i Objekteve shendetsores	PO	6700,33	7906,40	JO
4.	Ahmet R. Rrustemi B.I., Xhemali Mustafa III/42, 60000, Gjilan	112020	Dezifekant ,Mirembajtja e tunelit si dhe	PO	3424,48	4176,20	JO

Ne kemi dorëzuar një ofertë konform kërkesave të DT e cila ka përmbush kërkesat e AK dhe e cila ka qenë e përgjegjshme, AK ka kërkuar sqarim edhe lidhur me cmimin ton të dhënë, ne qëndrojm pran ofertës tonë dhe e përmbushin cdo kriter te kerkuar nga AK .

Ne kemi një ofertë me cmim më të ulët dhe me qëllim të ruajtjes së parasë publike për të cilë AK është i thirrur dhe i autorizuar sipas nenit 1 dhe 6 të LPP ka qenë i detyratur të veproj konform këtyre dispozitave.

**AK me rastin e vlersimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP Barazia në trajtim/jo diskriminim citat i nenit 7.1."Autoriteti kontraktues do të trajtoj OE në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë jo diskriminuese.**

AK me eliminimin tonë si OE të cilit kemi pas ofertën tonë me cmim më të ulët ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat i nenit 1.1 të LPPës:

" 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Po ashtu edhe neni 6 i LPP-së i obligon AK të sigurojnë fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike citat i nenit 6 të LPP-së:

" Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

AK nuk ka bërë vlersimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59.4 të LPP.

**Paragrafi 4 i nenit 59 të këtij ligji, përcakton, citojmë:**

"4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe

*kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."*

*AK si kriter të saj për dhënien e kontratës është përcaktuar për tenderin e përgjegjshëm me qmim më të ulët ashtu siq e parasheh neni 52 të LPP por në praktik është e kundërta me veprimet e saja AK eliminon ofertën e përgjegjshme me cmim më të ulët duke rekomanduar për kontratë OE me cmim më të lartë me që rastë dëmton buxhetin e Republikës së Kosovës me qindra euro.*

*Neni 60 –Kriteret per dhenjen e kontrates,AK do ti jap kontraten publike operatorit ekonomik qe ka dorezuar;*

*Tenderin e pergjegjshem me cmimin me te ulet.*

*A eshte shpallur/shperblyer Operatori Ekonomik me cmimin me te ulet ne kete tender,eshte qarte qe jo.*

**1.Autoriteti Kontraktues bie ndesh me kerkesat e veta ne kerkesen e pare te dates 30.11.2020,si arsyetim ,na ceket cmimi jo normalisht i ulte.**

Ne procesverbalin e hapjes se tenderit shihet qarte se kemi aplikuar 4 operator ekonomik

1.EVERY DAY VM-ME CMIM	9,451.40 EURO
2.MEB L.L.C ME CMIM	8,572.00 EURO
3.SV VETERINA 65 ME CMIM	7,906.40 DHE
4.AHMET R.RUSTEMI B.I ME CMIM	4,176.20 EURO

Dhe pretendimet se:

**Ja ku eshte arsyetimi I AK I cili eshte i pa baze ;**

Duke u bazuar ne Rregullat per tenderët Jo-Normalisht te ulet nenin 3,ku ju i keni plotësuar te gjitha kushtet per tu trajtuar oferta e juaj si tender jo normalisht te ulet pasi :

Çmimi i ofruar nga Ju është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;**

Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;**

Janë dorëzuar të paktën **3 (tre) tenderë. Komisioni i vlerësimit te ofertave ka konsideruar** që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, për pozicionet si në vijim:



Pjeset kan garancion 12 muaj per kete arsye nuk kemi kerkuar extra cmim.

Ne funde;

Ne dosje te tenderit :

#### IV.6 KRITERET PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Kontrata do t'i ipet operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

Tenderin e përgjegjshëm, me çmimin më të ulët ☒ ose

tenderin e përgjegjshme ekonomikisht më të favorshëm të përcaktuar në bazë të peshës së kritereve të përshkruara në Aneksin 4

#### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

*Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,*

*Shpenzimet e përgaditjes së tenderit,*

*Shpezimet e ankesës.*

*Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë*

*Fitimi i planifikuar për këtë tender*

#### 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *Flete pagesa per ankesen*



- b) *Ankesa drejtuar OSHP-se*
- c) *Kerkesa per rishqyrtim*
- d) *Njoftim per kontrat*
- e) *Procesverbali i hapjes se tenderit*
- f) *Leterstandarde per tenderuesin e eliminuar*
- g) *Vendimi per kerkesen per rishqyrtim*
- h) *Njoftimi i vendimit te AK*